

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Paradoksi i popullësisë: Në Shqipëri lindin më shumë djem por ka 28 mijë gra më shumë sesa burra - Inf ormohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/paradoksi-i-popullesise-ne-shqiperi-lindin-me-shume-djem-por-ka-28-mije-gra-me-shume-sesa-burra/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:46:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 11:31:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7d3f6365c1d0118a2d58153ce8fc58f5cce8dc4812ef28a287215d030a32dd8f
TEKSTI	7167b1eeb066d604752927ab052369dca2c28b67bcae39d1795de6147ac0bdcc
PAMJA	550fa4792b02e2adc674925adeadb9be0ccabe6c468becd28b2499209c94151e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9cfeebafc49d9141dc8650526b34b8c1be62af6b4a498af776d7d6f988caf79c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9cfeebafc49d9141dc8650526b34b8c1be62af6b4a498af776d7d6f988caf79c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Paradoksi i popullësisë: Në Shqipëri lindin më shumë djem por ka 28 mijë gra më shumë sesa burra

EKONOMI

Demo

Paradoksi i popullësisë: Në Shqipëri lindin më shumë djem por ka 28 mijë gra më shumë sesa burra

SEPTEMBER 22, 2026



Ndonëse në vend vazhdojnë të lindin më shumë djem sesa vajza, në Shqipëri ka më shumë gra sesa burra, sipas të dhënave të INSTAT. Në fund të vitit 2025 kishte 1,181,981 gra dhe 1,153,949 burra, ose rreth 28 mijë më shumë gra se burra.

Për lindjet, në Shqipëri vijojnë të dominojnë djemtë me 108 djem për 100 vajza. Emigracioni më i lartë i meshkujve dhe jetëgjatësia më e lartë e femrave janë arsyt kryesore që çojnë në përbysje të raporteve. Dominimi i femrave është i dukshëm dhe në arsim, me 65% të tyre që janë me arsim të lartë. Por në politikë gratë përbënin vetëm një të tretën e Kuvendit.

Gjetjet kryesore të INSTAT:

Popullsia

o Në fund të vitit 2025, popullsia banuese në Shqipëri ishte 2.335.930 banorë, nga të cilët 50,6 % ishin gra dhe 49,4 % burra. Krahasuar me fundin e vitit 2024, popullsia e burrave u ul me 1,3 %, ndërsa ajo e grave me 1,0 %.

o Shtesa natyrore e popullsisë në vitin 2025 ishte pozitive, me 1.063 lindje më shumë se vdekje për gratë dhe 84 për burrat.

o Në vitin 2025 u regjistruan 22.541 lindje të gjalla, 769 më pak se në vitin 2024. Raporti gjinor në lindje ishte 108 djem për çdo 100 vajza të lindura.

o Vdekshmëria foshnjore ishte 5,6 vdekje për 1.000 lindje të gjalla për djemtë dhe 3,8 për vajzat.

Shëndetësia dhe abortet

o Në vitin 2025, sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut mbetën shkaku kryesor i vdekjeve për të dyja gjinitë, duke përbërë 54,5 % të vdekjeve të gratë dhe 51,6 % të burrat.

o Gjatë vitit 2025 u regjistruan 4.277 aborte dhe 22.541 lindje të gjalla, me një raport prej rreth 190 abortesh për çdo 1.000 lindje të gjalla.

o Ndër moshat 15-19 vjeç, raporti më i lartë i abortit u regjistrua në moshën 18 vjeç, me 176,8 aborte për 1.000 lindje të gjalla në këtë moshë.

o Pjesa më e madhe e aborteve u regjistrua te gratë e grupmoshës 20-34 vjeç, të cilat përbënin 56,8 % të aborteve gjithsej në vitin 2025.

Postimet e reja

Arrestohet në Rusi një nga personat më të kërkuar...

SEPTEMBER 23, 2026

E ardhmja e Merz nën presion, 45% e...

SEPTEMBER 23, 2026

Ish-producenti i Hollywood-it Harvey...

SEPTEMBER 23, 2026

Presidentja në detyrë i ftoi në takim, familjet...

SEPTEMBER 23, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 22, 2026

Kreditorët të dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Situata financiare e një prej ish-gjigantëve të grumbullimit dhe eksportit të fruta perimeve, "Top Fruits",...

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznes të paktën 1-vjeçare

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

Na ndiq

o Në vitin akademik 2024-25, në arsimin e lartë u diplomuan 28.939 studentë, nga të cilët 65,3 % ishin vajza. Pësia e vajzave mes të diplomuarve u ul me 0,5 pikë përqindjeje, krahasuar me vitin akademik 2023-24.

Në vitin shkollor 2025-26, gratë përbënin shumicën e stafit mësimor në arsimin 9-vjeçar dhe në arsimin e mesëm të lartë, përkatësisht 79,6 % dhe 71,7 %. Në stafin akademik me kohë të plotë të arsimit të lartë, ato përbënin 35,8 % të kategorisë "Profesor", 60,5 % të kategorisë "Doktor" dhe 58,3 % të kategorisë "Akademikë e pedagogë pa tituj".

o Në vitin akademik 2024-25, ndër vajzat e diplomuara, peshën më të lartë e kishin fushat "Shëndet dhe mirëqenie" (27,6 %), "Biznes, administrim dhe ligj" (24,6 %) dhe "Shkenca sociale, gazetari dhe informacion" (11,0 %). Ndër djemtë e diplomuar kryesonin "Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim" (25,1 %), "Biznes, administrim dhe ligj" (20,8 %) dhe "Teknologji e informacionit dhe komunikimit"

(14,0 %). o Në vitin 2025, të popullsia 25 vjeç e lart, 50,0 % e grave dhe 42,3 % e burrave kishin arsim fillor ose 8/9-vjeçar. Për arsimin e mesëm të lartë, përqindjet ishin 30,0 % për gratë dhe 40,2 % për burrat, ndërsa për arsimin e lartë 19,9 % dhe 17,6 %, përkatësisht.

Tregu i punës dhe mbrojtja sociale

o Në vitin 2025, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për grupmoshën 15-64 vjeç ishte 82,7 % për burrat dhe 70,1 % për gratë. Shkalla e punësimit ishte përkatësisht 76,0 % dhe 62,7 %.

o Ndër gratë e punësuar të moshës 15-64 vjeç, 55,2 % ishin të punësuar me pagë dhe 25,0 % punëtore pa pagesë në biznesin e familjes.

o Bujqësia zinte peshën më të madhe në punësimin e grave, me 38,4 %. Në tregti, transport, hotelieri, shërbime të biznesit dhe administrative punonin 24,1 % e grave të punësuar dhe 31,1 % e burrave të punësuar.

o Shkalla e papunësisë për grupmoshën 15-64 vjeç ishte 8,2 % për burrat dhe 10,6 % për gratë. Krahasuar me vitin 2024, ajo u ul me 0,7 pikë përqindjeje për burrat dhe u rrit me 0,6 pikë përqindjeje për gratë.

o Ndër personat ekonomikisht joaktivë të moshës 15 vjeç e lart, 15,1 % e grave dhe 0,7 % e burrave deklaruan përmbushjen e detyrave shtëpiake si statusin e tyre kryesor.

o Gratë përbënin 55,3 % të punëkërkuarve të papunë të regjistruar. Sipas nivelit arsimor, 49,4 % e grave dhe 47,3 % e burrave punëkërkuar të papunë kishin arsim të mesëm të ulët (9-vjeçar).

o Në fund të vitit 2025, gratë përbënin 48,4 % të përfituesve të pensioneve urbane dhe 69,1 % të përfituesve të pensioneve rurale.

o Hende ku gjinor në paga ishte 4,6 %, nga 4,9 % në vitin 2024. Paga mesatare mujore bruto e grave ishte 4,6 % më e ulët se ajo e burrave.

Gratë në vendimarrje

o Në vitin 2025, gratë përbënin 35,0 % të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me 49 gra nga 140 deputetë gjithsej.

o Në misionet diplomatike, gjatë vitit 2025, gratë përbënin 37,5 % të ambasadorëve dhe 66,7 % të personave në pozicionin "Ministër Fuqplotë".

o Në vitin 2025, numri i huamarrësve në bankat tregtare ishte 348.053, prej të cilëve 55,2% ishin burra dhe 44,8% ishin gra.

o Në vitin 2025, 31,6 % e ndërmarrjeve aktive kishin pronarë ose administratorë gra. Përqindja ishte më e lartë në ndërmarrjet me 1-4 të punësuar, ku arriti në 32,7 %.

o Pësia e ndërmarrjeve me pronarë ose administratorë gra ishte 33,9 % të prodhuesit të shërbimeve dhe 17,5 % të prodhuesit të mirave. Këta tregues nuk përfshijnë fermerët e regjistruar.

Tregues socialë nga anketat në familje

o Në vitin 2024, shpenzimet mesatare mujore për konsum ishin 93.042 lekë për njësi ekonomike familjare. Ato ishin 96.359 lekë për familjet me kryefamiljar burrë dhe 76.235 lekë për familjet me kryefamiljare grua.

o Në vitin 2025, 87,2 % e individëve të moshës 16-74 vjeç kishin përdorur internetin gjatë tre muajve të

tundit: 88,1 % e burrave dhe 80,3 % e grave.

o Ndër blerësit online të veshjeve dhe mallrave sportive në vitin 2025, 55,6 % ishin gra dhe 44,4 % burra. Për blerjet e kompjuterëve dhe pajisjeve kompjuterike, përqindjet ishin 50,9 % për gratë dhe 49,1 % për burrat.

o Në vitin 2024, shkalla e rrezikut për të qenë i varfër ishte 19,2 %, nga 19,8 % në vitin 2023, duke shënuar një ulje prej 0,6 pikë përqindjeje. Ky tregues ishte 19,5 % për gratë dhe 18,9 % për burrat.

o Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE) ishte 40,5 % në vitin 2024, përkatësisht 41,5 % për gratë dhe 39,4 % për burrat./Monitor

28 mijë gra më shumë	aktualitet	burra	Censi i Popullsisë	census	demografia	demografia shqiptare	
djem	gra	instat	lajme Shqipëri	lindin më shumë djem	lindjet	lindshmëria	ndryshimet demografike
Popullsia	Popullsia e Shqipërisë	raporti gra burra	shifrat e popullsisë	shqipëri	Shqipëri 2026	statistika	
statistika demografike	statistikat e popullsisë	struktura e popullsisë	të dhëna INSTAT	vajza			

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët,
mundësi fitimi dhe sfida në punë,
çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3
shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.